

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"BERAT TRADE"

Më datë 06.12.2012, mbështetur në ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", dhe akte të tjera ligjore e nënligjore, në cilësinë e Ortakëve themelues:

1. Shoqëria "CONAD ALBANIA" SH.P.K, shoqëri e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me NIPT L21423017V, me seli në Tiranë (Shqipëri) në Autostradën Tiranë-Durrës, km 6, magazina nr.1 përfaqësuar-në bazë të vendimit të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë date 05.12.2012 - nga:
 - Z.Adrian Dulaku, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë(Shqipëri) më 5 shkurt 1960, me vendbanim në Tiranë(Shqipëri) me letërnjoftimi nr.028000393.
 - Znj.Eda Leka, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë(Shqipëri) më 28 mars 1983, me vendbanim në Tiranë(Shqipëri) me letërnjoftimi nr.025331456.

2. Shoqëria "BOMIRA" SH.P.K, shoqëri e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me NIPT K02701016D, me seli në Ura Vajgurore Berat(Shqipëri), e përfaqësuar-në bazë të vendimit të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë nr.4 datë 05.12.2012- nga Z.Ylli Aliaj shtetas shqiptar, lindur në Kapaj Fier (Shqipëri) më 8 shkurt 1961, me vendbanim në Berat (Shqipëri) me letërnjoftimi nr.026868484.


deklarojnë se kanë vendosur të nënshkruajnë këtë kontratë themelimi për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (me poshtë refereruar si Shoqëria), me termat e mëposhtëm:

Neni 1
Emërtimi

Shoqëria emërtohet "BERAT TRADE" SH.P.K. Emërtimi i shoqërisë mund të shkruhet me shkronja të mëdha ose të vogla.

Neni 2
Selia

Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet në Lagjja "28 Nëntori", rruga "Antipatrea", ish Markata, Berat (Shqipëri). Shoqëria sipas legjislacionit në fuqi, mund të hapë në Shqipëri dhe jashtë saj, qendra, përfaqësi, filiale, degë dhe shoqëri të tjera.




Neni 3
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Me vendim të Asamblesë së Ortakëve mund të përcaktohet një afat kohezgjatjeje i cili mund të ndryshohet një ose më shumë herë, sërish me një vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4
Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Menaxhimin, blerjen, marrjen me qira, ndertimin, dhënien me qira ose menaxhim, sikurse edhe shitjen e aktiviteteve tregtare me shumicë apo me pakicë dhe të veprave ose strukturave që kanë lidhje me këto aktivitete;
- Ndërtimin, menaxhimin dhe shitjen e dyqaneve për shitje të mallrave me shumicë ose me pakicë, për llogari të vet ose të të tretëve.
- Blerjen, me për rifurnizimin, e mallrave ushqimore të përgjithshme, në bashkëpunim me shoqëri ose entitete të tjera si dhe import-eksportin e mallrave të ndryshme që do të jenë objekti i aktivitetit tregtar;
- Hapjen dhe drejtimin e "Agjensive Doganore" në të gjithë teritorin e Shqipërisë për kryerjen e çdo praktike doganore, pasi të jetë paisur paraprakisht me lejet e nevojshme të lëshuara nga organet kompetente;
- Prodhimin, vetë, në forëm të asociuar ose në ortakëri me shoqata ose shoqëri të tjera, të produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore me destinacion rishitjen në pikat e veta të shitjes ose të shoqërive ortake ose të kontrolluara prej saj si dhe/ose për eksportim;
- Rritjen dhe shndërrimin e produkteve me origjinë ushqimore, për qellime tregtimi brënda dhe jashtë Shqipërisë;
- Dhënien me qira të pasurive të paluajtëshme në përgjithësi, blerjen, drejtimin, transformimin dhe shitjen e tokave bujqësore, sikurse edhe çdo veprim tjetër mbi pasuri të luajtëshme e të paluajtëshme si dhe studimin dhe ndërtimin ose blerjen dhe shitjen e ndërtesave që kanë lidhje me këtë kategori;
- Ofrimin e shërbimeve administrative, konsulencave mbi pronën e paluajtëshme, financiare menaxhuese dhe teknike;
- Marrjen hua dhe dhënien e dorëzanive dhe garancive të tjera reale dhe personale edhe në favor të të tretëve;
- Drejtimin e veprimtarive tregtare me pakicë në bashkëpunim edhe me shoqëri të tjera, me të cilat do të lidhë kontrata franchising dhe furnizimi;
- Për realizimin e objektit të veprimtarisë së saj, Shoqëria mund të kryejë, gjithashtu, si aktivitet ndihmës dhe jo parësor, të gjitha veprimet mbi pasuri të luajtëshme dhe të paluajtëshme, industriale, financiare dhe tregtare, në Shqipëri si dhe jashtë saj, në masën që



vlerësohet e dobishme dhe/ose e përshtatshme nga organi administrativ dhe mundet gjithashtu të marrë përsipër gjithmonë për veprime ndihmëse, pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive ose ndërmarrjeve dhe ose entiteteve të tjera me objekt të ngjashëm, të afërt ose të lidhur me të vetin, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe çdo aktivitet tjetër të lejuar nga ligjet në fuqi.

Të gjitha veprimtaritë e përshkruara më sipër mund të zhvillohen si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.

Neni 5 Kapitali i Regjistruar

Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë) lekë.

Kapitali i regjistruar është i përbërë nga 100 (njëqind) kuota kapitali me vlerë nominale 1000 (njëmijë) lekë secila, të gjitha të nënshkruara e të paguara.

Kuotat e nënshkruara të kapitalit janë shlyer tërësisht

Neni 6 Kuotat e Kapitalit të Regjistruar

Derdhja e kapitalit themeltar është bërë në masën dhe mënyrën e mëposhtme:

- Shoqëria "CONAD ALBANIA" SH.P.K ka kontribuar në para në shumën 51.000 (pesëdhjetenjëmijë) lekë.
- Shoqëria "BOMIRA" SH.P.K ka kontribuar në para në shumën 49.000 (dyzetënëntëmijë) lekë.

Sipas kontributeve në kapitalin e regjistruar të shoqërisë pjesët e tij ndahen:

- Shoqërisë "CONAD ALBANIA" SH.P.K i takojnë 51 (pesëdhjetenjë) kuota kapitali ose 51% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
- Shoqërisë "BOMIRA" SH.P.K i takojnë 49 (dyzetënëntë) kuota kapitali ose 49% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Këto pjesë janë shlyer tërësisht.

Neni 7 Kuotat dhe kalimi i kuotave të kapitalit

Zotërimi i kuotave, mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave, pjesëtimi dhe transferimi i tyre do të bëhen sipas procedurave të parashikuara në ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i shoqërisë.

Neni 8 Administrimi

Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator persona fizike, qofshin këta edhe jo ortak të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori/ët qendrojnë në postin e tyre për pesë vjet, me mundësinë për tu



rizgjedhur. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo statuti i jep Asamblesë duke përfshirë delegimin e kompetencave edhe personave të tjerë me prokurë të posaçme.

Administratori i parë i shoqërisë është Z. Pietro Tafuni shtetas Italian, i datëlindjes 08.07.1952, lindur në Desio (MB) dhe banues në Itali, Via del Tiziano 2 ne San Benedetto del Tronto, mbajtës i letërnjoftimit me nr. YA307821. Ai do të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për rregjistrimin e shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR). Të gjitha shpenzimet që do të kryen deri në rregjistrimin e shoqërisë si person juridik do të përfshihen në bilancin e shoqërisë.

Neni 9 Të tjera

Shoqëria do ta ushtroje aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Kushtet e punës, shpërblimet, oraret, pushimet dhe sigurimet shoqërore të personelit do të rregullohen nga kontrata kolektive ose ajo individuale e punës, si dhe nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Neni 10 Kundërshtimet

Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj, midis ortakëve ose një apo më shume prej tyre dhe shoqërisë, do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë midis të interesuarëve për të zgjidhur miqësisht. Në rast të mos renies dakort brenda 30 diteve i nënshtrohen juridiksionit të Gjyqesës së Rrethit Gjyqësor Tirane e vetmja kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

Neni 11 Të tjera

Ky Akt Themelimi është përgatitur në gjashtë kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË “BERAT TRADE” SH.P.K

“CONAD ALBANIA” SH.P.K

E përfaqësuar nga
ADMINISTRATORËT
ADRIAN DULAKU EDA LEKA



“BOMIRA” SH.P.K

E përfaqësuar nga
ADMINISTRATORI
YLLI ALIAJ

